

Në pajtim me autoritetin e dhënë me *Ligjin Nr. 03/L-086, Mbi Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe Mbeturinave*, të datës 13 qershor 2008 me të cilën është amendamentuar *Rregullorja 2004/49 ("Ligji")*

Duke u bazuar në të dhënat e aplikacionit për Tarifa Shërbimi të dorëzuara nga NH "IBËR-LEPENC" Sh. A. Prishtinë, dhe në procesin e zhvilluar të analizave dhe të vlerësimit të tyre,

Konform Nenit 15 të *Rregullës për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe të Furnizimit të Ujit me Shumicë në Kosovë* të datës 12 gusht 2008 (Rregulla - ZRRUM R 02/U&K),

Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina ("ZRRUM") lëshon këtë:

URDHËRESË TË TARIFAVE TË SHËRBIMIT

PËR PËRCAKTIM TË TARIFAVE PËR SHËRBIMET E UJIT ME SHUMICË TË PA TRAJTUAR QË DUHET TË APLIKOHEN NGA NH "IBËR-LEPENC" SH. A. PRISHTINË

1. Interpretimi

Në këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit, përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, fjalët dhe shprehjet me shkronja të mëdha do të kenë kuptimin që u atribuohen Rregullës ZRRUM- R 02/U&K.

2. Zbatueshmëria

Kjo Urdhëresë e Tarifave të Shërbimit është e zbatueshme dhe e detyrueshme për NH "IBËR-LEPENC" Sh. A. Prishtinë me rastin e faturimit të shërbimeve të furnizimit me ujë të pa trajtuar me shumicë, për dy ujësjellës regjional, dhe atë; për KUR "Mitrovica" Sh. A. Mitrovicë dhe KUR "Prishtina" Sh. A. Prishtinë për Drenas.

3. Lista e Tarifave të Shërbimit

NH "IBËR-LEPENC" Sh. A. Prishtinë. për konsumatorët e vet do të aplikojë Tarifat e Shërbimit të ujit me shumicë të pa trajtuar ashtu siç janë në Tabelën e më poshtme:

Tabela e tarifave të Shërbimit të aplikueshme nga NH "Ibër-Lepenci" Sh.A.

Nr. rendor	Shfrytëzuesit e ujit me shumicë të pa trajtuar	Njësia matëse	Tarifa
1	KUR "Prishtina" Sh. A. Prishtinë për Drenas	m3	0,040
2	KUR "Mitrovica" Sh. A. Mitrovicë	m3	0,0153

4. Afati

Tarifat e përcaktuara me këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit do të jenë të zbatueshme për periudhën **1 janar 2009 deri më 31 dhjetor 2009**. ZRRUM mund ti bëjë korrigjimet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të tarifave në bazë të kërkesës së NH "IBËR-LEPENC" Sh.A. Prishtinë, në pajtim me nenin 16 të Rregullës ZRRUM- R 02/U&K.

5. Publikimi dhe Shpërndarja e Listës së Tarifave të Shërbimit

NH "IBËR-LEPENC" Sh. A. Prishtinë duhet të njoftojë Kompanitë e Ujësjetësve Regional të cilat i furnizon me uji me shumicë të pa trajtuar me Tarifa të Shërbimi të përcaktuara nga ZRRUM'i, sipas kësaj Urdhërese Tarifore të Shërbimit, me rastin e nënshkrimit të Kontratës për Shërbime ose tua dërgojë të njëjtave kopjen e saj me faturën e radhës.

6. Apelet

NH "IBËR-LEPENC" Sh. A. ka të drejtë të apelojë tek Komisioni për Shqyrtim që themelohet konform nenit 34. Komisioni shqyrtues, pika 34.1., Ligji Nr.03/L-086 mbi Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetës, Kanalizimit dhe Mbeturinave, të datës 13 qershor 2008

7. Gjuha Zyrtare e Urdhrit të Tarifave për Shërbime

Kjo Urdhëresë e Tarifave të Shërbimit nxjerret dhe publikohet në tri (3) versione të shkruara të gjuhëve zyrtare që përdoren në Kosovë: (i) Shqip, (ii) Serbisht dhe, (iii) Anglisht.

Në rast të mospërputhjeve në mes të versioneve, do të mbizotërojë versioni i shkruar në gjuhën Shqipe.

.....
Afrim Lajçi
Drejtore i ZRRUM